

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Trashupa, në çështjen penale, kundër të pandehurit A.H., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31, të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1862/2016, të dt.21.02.2017, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 27.04.2018, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit, Hava Krasniqi, i pandehuri A.H., në bazë të nenit 366 të KPPRK-së, me datë **27.04.2018**, morri dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri: **A.H.**, nga i ati E. dhe e ëma Q., e gjinisë L., i lindur më ..., në fshatin M., tani me vendbanim në Rr."H.Z.", nr..., P., me numër personal ..., me numër të tel. ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**S e p s e:**

Me datën 30.03.2016, rreth orës 16:10, në P., në rrugën H.Z.", nr ..., të pandehurit N. dhe A.H., pas mosmarrëveshjes që kishin me të dëmtuaren, të njëjtit e kanë sulmuar fizikisht të dëmtuaren E.H., duke e goditur me shqelma nëtrup dhe duke e kapur për flokësh, me qëllim që të largohet nga salloni, pasi që e dëmtuara jeton me djalin dhe bashkshortin e saj, në të njëjten shtëpi, por në dhomën tjetër;-

-me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të Republikës së Kosovës, të pandehurit A.H. i shqipton:

**D Ë N I M M E G J O B Ë**

I pandehuri: **A.H.** dënohet në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësorë në shumën prej **20 (njëzet) €**, si dhe për ekspertizën mjeko – ligjore në shumën prej **20€ (njëzet)**, të gjitha këtonë afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara: **E.H.**, me vendbanim në Rr."H.Z.", në P., me numër të tel. ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.1862/2016, të dt.21.02.2017, kundër të pandehurve N.H. dhe A.H., për shkak tëveprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31, të KPRK – së.

Për të pandehuren, N.H, në bazë të nenin 485 par. 2 të KPPRK-së, ka përfunduar procedura penale, pasi që gjykata ka lëshuar aktgjykim me urdhër ndëshkimor P.nr.885/2017, të datës 16.05.2017, aktgjykimi i lartcekur është bërë i formës së prerë.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin P.nr.5066/2017 të datës 05.01.2018P.nr.885/2017, të datës 16.05.2017, e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka lëshuar Urdhër ndëshkimor përmes së cilin të akuzuarin A.H., e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31,të KPRK – së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro. Kundër këtij Aktgjykimi i pandehuri A.H. brenda afatit ligjor ka ushtruar kundërshtim.

Lidhur me këtë çështje penale kundër të pandehurit A.H., gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 27.04.2018.

Që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale Sulm nga neni 187 par. 1 të KPRK-së. Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari e ka pranuar akuzën në tërësi dhe është i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë për veprën penale Sulm nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31,të KPRK-së, të cilin pranim të fajësisë e ka bërë pasi që gjykata e ka njoftuar në hollësi për natyrën dhe pasojat e pranimit të tillë, duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, i pandehuri deklaroi se ndjehet fajshëm dhe kërkoj dënim më të lehtë nga gjykata, pasi qëjam student dhe kam gabuar.

Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, pikërisht se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK-së.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve të parapara në nenin 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen dhe administrimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, se i pandehuri e ka kryer veprën penale të lartcekur, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nisur nga pranimi i fajësisë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Sulm nga neni 187 par. 1 lidhur me nenin 31,të KPRK-së, për të cilën i njëjti edhe akuzohet. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit. Ashtu që për të pandehurin A.H., si rrethana lehtësuese gjeti se: i akuzuari e pranoj fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt në gjykatë, se nuk ka qenë e dënuar më parë, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti. Gjukata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga çfarë tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.885/2017, me datë 21.05.2018**

Procesmbajtëse  
Sanije Troshupa

Gjyqtar  
Rrustem Begolli

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm përmes kësaj Gjykate